


## 1) Testoni tokën

Bimë shumë e ndieshme ne tokat me pH acidike (pH <5.5 )

- Nëse pH-ja është më e ulët, shtoni gur gëlqeror 1 vit para se të mbjellni jonxhen.
- Shtoni pleh fosfori, kaliumi, bori dhe sulfuri, gjë që rekomandohet me testimin e tokës.
- Tokat më të përshtatshme janë tokat argjillore ranore ose ranore –argjillore për kultivim.
- Tokat e Ftohëta dhe shumë të rënda dhe me ujra nëntoksore (< 1.5m ) nuk janë të përshtatshme për kultivimin e jonxhes .

Kufijt me optimal për zhvillim të bimes ,pH-ja e tokës duhet të jetë rreth 6.5-7.5



Efekti i pH-së së tokës në rendiment

- Tokat acidike dhe ato me ujëra nëntoksore ndikojnë në :
- Rallimin e shpejtë të bimëve
- Jetëgjatesia prodhuese e bimëve e shkurter
- Numri i bimeve ne vitin e 4 zvoglohet deri ne 30 %

## 2) Përzgjidhni një varietet të mirë

Disa varietete kultivohen më mirë dhe prodhojnë më shumë se të tjerat



## 3) Zgjedhni metodën më të mirë për kultivim

- Hedhja e drejtpërdrejtë e farës
- Thellsia e mbjelljes 1-3 cm ,ne rende 7.5-15 cm ndersa per farë 35-55 cm .
- Me bimë shoqëruese
  - Përdorni tërshërë, 60 kg/ha
  - ose 4 kg/ha thekër italiane

## 4) Te mbillet në kohën e duhur

- Mbjellja në pranverë ose në verën e vonshme funksionon mirë
- Mbjellni në fillim të prillit ose në mes të gushtit

## 5) Përgatitni një shtrat të fortë dhe të lëmueshme

Siprefaqja e tokës duhet të mos ketë barëra të këqija. Toka duhet të mos ketë bucë/bosa. Duhet të jetë mjaft e fortë, në mënyrë që këpuca të mos zhytet më shumë se gjysmë cm.

## 6) Përdorni shkallën e duhur të mbjelljes

- 1 kg/ha = 50 fara/m<sup>2</sup>
- Prisni një rritje të shpejtë prej 60% nëse farat janë të mira
- 40% mbeturina të bimës gjatë sezonës së parë
- Synimi në fund të vitit të mbjelljes është 200 deri 300 bimë/m<sup>2</sup>

## 7) Fusni farën me bakterie Rhizobia Meliloti

- Injektimi duhet të jetë më pak se 6 muaj i vjetër dhe duhet të mbahet në vend të ftohtë derisa të përdoret.
- Akvizimi i Bakteriveve Azotofiksuese mvaret nga
  - 1) PH -ja e tokës
  - 2) Prania e pa balansuar e lendeve ushqyese
  - 3) Mungesa e Ajrit si dhe temperatura e jashtme (Lartë ose e ulë).



Pa (në të majtë) dhe me (në të djathtë) inokulim

## 8) Vendosni farën në thellësi të duhur

Vendosni farën në thellësi 0.6 deri 2 cm  
Distanca e mbjelljes 7.5-15 cm per fare 35-50 c

## 9) Kontrolloni barin e keq gjatë 60 ditëve të para pas mbjelljes

Gjatë 60 ditëve të para barërat e këqia do ta hollojnë pozicionin. Spërkatni nëse barërat e këqia janë më pak se 10 cm të gjata ose nëse jonxha është mbi 35 cm e gjatë dhe korni barërat e këqija për t'i kontrolluar ato

## 10) Prisni 60 ditë pas mbjelljes

- 1 deri 3 prerje gjatë një viti të mbjelljes.
- Prisni 30- 40 ditë pas kositjes paraprake

## Pse kultivohet jonxha?

1. Ushqimi foragjer i cilësisë së lartë
2. Burim energjie për kafshët
3. Në masen e njomë jonxha ne fazen Gonxhim -fillimi i lulezimit ,ka një perberje mesatare :

| Ujë | Proteina | Energjia | Celulozë | Minerale |
|-----|----------|----------|----------|----------|
| 70% | 4.3 %    | 9.7 %    | 8.4 %    | 2.2 %    |

4. Nuk ka nevojë për plehun me azot
5. Siguron plehun azotik për bimën tjetër/pasardhese
6. Pas përmbysjes 1 ha jonxhë siguron rreth 12 t lënd organike si dhe 90-150 kg Azot.
7. Përmirson strukturën e tokës/
  - Përmirson regjimin ujor dhe agror te tokes
  - PermisRon regjimin ushqyes duke shtuar N,dhe Ca.
8. Ndikon ne mbrojtje nga erozioni i tokës, sidomos ne tokat e pjerreta.

Misër (qoftë drithë ose silazh) dhe grurë 10 deri 15% krijon më shumë prodhim pas jonxhes sesa pas kultivimit të vazhdueshëm te kulturave tradicionale (Miser –grurë etj ).



Pas jonxhes nëse mbillet misri, luledielli ose grurë rendimenti do të jetë më i lart



Varietet i ri i testuar i jonxhes (Erba Medica)



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Mendimet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Projekti për Përkrahjen e Bizneseve dhe Kllastereve të Kosovës

## MËNYRA E DREJTË E KULTIVIMIT TË JONXHES

